



**VENDIM**

*Nr. 146 Datë 07.12.2011*

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA OST SH.A PËR PERIUDHËN E TRETË  
RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 59, datë 29.12.2005, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

**Vendosi:**

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 – 2014), do të jetë **0.65 leke/kWh**.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**